



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

B.Curri, më \_\_\_\_\_ .2025

**VENDIM  
Nr 82 Datë 24.12.2025**

**PËR**

**“MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE  
SOCIALE ME QIRA DHE SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PER VITIN 2026”**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; nenit 2 pika 45, nenit 3, 15,16 germa “ç”, 77 pika 10 të Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar sipas ligjit nr 48/2023. V.K.M-së 384 dt 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore”; VKM 362 date 29.05.2019.”Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi ne subvencionimin e qerasë ne tregun e lirë nëpërmjet buxhetit te shtetit dhe mënyren e llogaritjes se tij”. si dhe urdherit Nr.319 Date 12.11.2025, të ngritur nga Kryetari i Bashkisë “Për krijimin e komisionit të strehimit” pas diskutimeve Keshillit Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 24.12.2025

**VENDOSI**

1. Të miratoje vlerat e banesave me qera për bonuset e strehimit si me poshtë;

**TABELA E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE  
SOCIALE ME QIRA**

|            | KRITERET E PIKËZIMIT                                                                                                                     | Pikë      |
|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1.1</b> | <b>Kushtet e strehimit</b>                                                                                                               | <b>30</b> |
| A          | Nuk disponojnë banesë në pronësi                                                                                                         | 10        |
| B          | Banojnë në banesa rrezik shembjeje                                                                                                       | 8         |
| C          | Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi                                                               | 5         |
| Ç          | Kanë mbetur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha si rezultat i fatkeqësive natyrore ose i zbatimit të një vendimi gjyqësor               | 7         |
| <b>1.2</b> | <b>Kushtet familjare</b>                                                                                                                 | <b>20</b> |
| A          | Familjet e policëve të rënë në detyrë                                                                                                    | 5         |
| B          | Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t’u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore | 5         |
| C          | Familjet me më shumë se 4 fëmijë ose familje njëprindërore                                                                               | 5         |
| Ç          | Familje të minoriteteve Rome dhe Egjiptiane                                                                                              | 5         |

|            |                                                                                                                        |           |
|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1.3</b> | <b>Kushtet sociale</b>                                                                                                 | <b>20</b> |
| A          | Persona me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave                | 8         |
| B          | Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç | 6         |
| C          | Emigrant i rikthyer, punëtor emigrant                                                                                  | 2         |
| Ç          | Viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit                                                                            | 4         |
| <b>1.4</b> | <b>Kushtet ekonomike</b>                                                                                               | <b>30</b> |
| A          | Të ardhura nën 80% të të ardhurave mesatare                                                                            | 15        |
| B          | Të ardhura deri 80% - 100% të të ardhurave mesatare                                                                    | 10        |
| C          | Të ardhura 100% - 120% të të ardhurave mesatare                                                                        | 5         |

Shënim

Pikët maksimale që mund të përfitojë një familje janë 100. Nuk mund të mblidhen brendapërbrenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në Ç të kriterit 1.1;
2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2; dhe
3. Nga A deri në C të kriterit 1.4.

Pikët nga A deri në Ç të kriterit 1.3 mund të mblidhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:

1. Pika A mund të mblidhet me njërin prej rasteve si më poshtë:

a) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;

b) Vetëm me pikën C;

2. Pika B mund të mblidhet vetëm me pikën A.

3. Pika C mund të mblidhet vetëm me pikën A.

4. Pika Ç mund të mblidhet me pikat A e B së bashku ose me njërin prej tyre.

Në total mbledhja e pikëve A, B e Ç nuk duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.

2. Ngarkohet Komisioni i Strehimit Bashkiak Tropoje, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Shpallur me 30.12.2025, Miratuar me 12 vota, Vota Pro 12, Vota Kunder 0, Vot Abstenim 0

SEKRETARI  
Ergent GJONGECAJ



KRYETARI  
Arber ÇAKRAJ

